



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.03, datë 14.12.2022

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
VAU I DEJËS, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.3, DATË 27.04.2018
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.3, datë 27.04.2018 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vau i Dejës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 81 datë 30.11.2022, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Vau i Dejës, të miratuar me Vendimin Nr.03, datë 27.04.2018, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:

- *Rregullores së Planit:*

- Pas nenit 18 “*Madhësia e njësisë/ zonës me PDV*”, shtohet neni 18/1 “*Rastet për të cilat bartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ ose i nevojshëm*”;
- Neni 23 “*Përmirësimi i kushteve të banimit dhe ndërtimet në sistemin jourban*”, ndryshohet;
- Pas nenit 23 “*Përmirësimi i kushteve të banimit dhe ndërtimet në sistemin jourban*”, shtohet neni 23/1 “*Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror*”;
- Në nenin 38 “*Kufizime sektoriale*”, shfuqizohet fraza “*Varreza 300m*”;
- Pas nenit 38 “*Kufizime sektoriale*”, shtohet neni 38/1 “*Vija Blu*” dhe neni 38/2 “*Burimet e ujrave*”;
- Në nenin 55 “*Varrezat*”, paragrafi i parë me titull “*Brezji Sanitar*”, ndryshohet;
- Pas nenit 69 “*Brezat e rezervuara jashtë dhe në qendrat e banuara*”, shtohet neni 69/1 “*Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C*”;
- Pas nenit 74 “*Furnizimi me energji elektrike*”, shtohet neni 74/1 “*Energjitë e rinovueshme*”;
- Pas nenit 75 “*Telekomunikacioni*”, shtohet neni 75/1 “*Hekurudhat*” dhe neni 75/2 “*Kanalet vaditëse/ Emisaret*”;
- Neni 78 “*Zgjidhja e paqartësive bazuar në saktësinë e informacionit*”, ndryshohet;
- *Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;*



Ndryshime të "Hartës së infrastrukturës së transportit të propozuar të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vau i Dejës".

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Vau i Dejës, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Vau i Dejës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Vau i Dejës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Belinda Balluku
BELINDA BALLUKU



Ledia Tota
ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

